

MARMOCRYL SILICONE Fine

Fino e gatshme me përmbajtje silikoni, në trajtë brumi
Sipërfaqe e lëmuar • E bardhë ose me ngjyrë • Aftësi ujëlarguese

Përshkrimi

MARMOCRYL SILICONE Fine është një suva e gatshme akrilike me përmbajtje silikoni, në trajtë brumi, e bardhë ose me ngjyrë. Përbëhet nga materiale inerte me madhësi të veçantë të grimcave të bluara, për të krijuar një sipërfaqe dekorative të lëmuar. Ajo ofron avantazhet e mëposhtme:

- Elasticitet të lartë dhe ngjitje të shkëlqyer me nënshtresën.
- Largim të plotë të ujit, sipas EN 1062-3.
- Përshkueshmëri të shkëlqyer të avujve të ujit.
- Mbrojtje ndaj kërpudhave dhe algave.
- Nuk është më e nevojshme lyerja e fasadës.
- Rezistencë ndaj lëndëve alkaline sipas DIN 18556.
- E përforcuar me fibra polipropileni për një mbrojtje efektive kundër plasaritjes.
- Thjeshtëzon dhe përshpejton përdorimin.
- Pjesë e sistemeve termoizoluese të jashtme të certifikuara ISOMAT THERMOSYSTEM.
- Përshtatshmëri për përdorim në mjedise të brendshme dhe të jashtme.

Është çertifikuar me shënjen CE sipas EN 15824:2017.

MARMOCRYL SILICONE Fine ka përfituar një Deklaratë Produkti Mjedisor (EPD) në vijim të një vlerësimi të impaktit mjedisor të ciklit të tij të jetës. Numri i regjistrimit: S-P-09188, The International EPD® System.

Fushat e përdorimit

MARMOCRYL SILICONE Fine përdoret si dora e fundit në punët e suvatimit, për të krijuar një shtresë sipërfaqësore finale të bardhë ose me ngjyrë, me aftësi ujëlarguese dhe me përbërje të lëmuar (shtresë e hollë). Ajo mund të aplikohet në të gjitha llojet e materialeve të ndërtimit, si suva, beton, pllaka çimentoje, pllaka gipsi etj. E përshtatshme për përdorim në ambiente të jashtme dhe të brendshme. Ajo zëvendëson dorën e fundit të suvasë.

Për shkak të elasticitetit të lartë dhe ngjitjes së shkëlqyer me nënshtresën, ajo mund të përdoret gjithashtu si shtresë ideale finale për fasadat e jashtme me termoizolim.

Të dhënat teknike

Trajta:	në formë brumi
Ngjyra:	me ngjyrë të bardhe dhe me ngjyra të zgjedhura përmes sistemit të ngjyrosjes ISOMAT COLOR SYSTEM
Densiteti:	1,80 ± 0,03 kg/l
Përshkueshmëria nga avujt:	V1 (EN ISO 7783-2, V1: High Sd<0,14m)
Përçueshmëria nga uji:	W3 (EN 1062-3, W3: Low w< 0,1 kg/m ² h ^{0.5})
Forca ngjitëse:	0,4 MPa (EN 1542)
Përçueshmëria termike:	λ=0,7 W/(m K) (EN 1745)
Reagimi ndaj zjarrit:	Euroclass B-s2,d0
Koha e tharjes:	4-6 orë (23°C, 50% R.H.)

Pastrimi i veglave:
Veglat duhet të pastrohen me ujë pas përdorimit.

Llojet në dispozicion

MARMOCRYL SILICONE Fine ofrohet në llojet e mëposhtme (sipas madhësisë të kokërrave):

Lloji	Trashësia e aplikimit
MARMOCRYL SILICONE Fine 1 mm	reth 1 mm
MARMOCRYL SILICONE Fine 1,5 mm	reth 1,5 mm
MARMOCRYL SILICONE Fine 2 mm	reth 2 mm

MARMOCRYL SILICONE Fine

Konsumi

Reth 1,8 kg/m²/mm.

Udhëzimet e përdorimit

1. Nënshtrësja

Sipërfaqja duhet të jetë e thatë dhe pa pluhur, materiale me vaj ose pa materiale të lira. Pas kësaj bëhet lyerja me astar duke përdorur astarin special ML-PRIMER. Sipërfaqet metalike duhet të lyhen me PL-BOND. MARMOCRYL SILICONE Fine aplikohet pasi është tharë shtresja e astarit të përdorur.

2. Përdorimi

MARMOCRYL SILICONE Fine duhet të trazohet mirë plotësisht përpara përdorimit. Suvaja aplikohet me dorë duke përdorur një shpatull të lëmuar metalike prej inoksi ose aplikohet me një makineri suvatuese. Kur është ende e njomë (pas rreth 5-20 minutash), suvaja trajtohet (ngjishet) me shpatull plastike. Koha e punës varet nga aftësia thithëse e nënshtrësës dhe temperatura e ambientit.

Ambalazhimi

MARMOCRYL SILICONE Fine ofrohet në enë plastike 25 kg.

Magazinimi

Afati i ruajtjes për përdorim në enë plastike të izoluara dhe në ambiente të mbrojtura nga ngrica dhe dielli dhe në temperatura ndërmjet +5°C dhe +35°C është minimumi 18 muaj.

Shënime

- Kokërrat natyrale që përdoren në suvaja mund shkaktojnë ndryshime të vogla në ngjyrë. Për këtë arsye dhe për të arritur një rezultat uniform ngjyre, rekomandohet që produkti të jetë nga i njëjti grup prodhimi ose të përziehen grupet e ndryshme. Gjithashtu, ngjyra përfundimtare mund të influencohet nga temperatura e nënshtrësës dhe nga lagështia.
- Temperatura gjatë aplikimit duhet të jetë nga +5°C deri në +35°C.

- Ndërsa është ende e njomë, MARMOCRYL SILICONE Fine duhet të mbrohet nga temperaturat e larta, nga shiu dhe nga ngrica.
- Shikoni rreziqet e përdorimit dhe këshillat për sigurinë që janë të shkruara mbi thes.

Përbërësit organikë të avullueshëm (VOC)

Sipas Direktivës 2004/42/KE (Shtojca II, tabela A), përmbajtja maksimale e lejuar e VOC-së për produktin e nënkategorisë "c", lloji WB është 40 g/l (2010) për produktin e gatshëm për përdorim. Produkti i gatshëm për përdorim MARMOCRYL SILICONE Fine përmban maksimumi <40 g/l VOC.

CE

ISOMAT S.A.

17th km Thessaloniki – Ag. Athanasios
P.O. BOX 1043, 570 03 Ag. Athanasios,
Greece

11

EN 15824

External render based on organic binder

DoP No.: MARMOCRYL SILICONE FINE/
1405-02

Water vapor permeability: V1

Water absorption: W3

Adhesion: 0.4 MPa

Durability: NPd

Thermal conductivity: $\lambda = 0.7$ W/(m K)

Reaction to fire: Euroclass B-s2,d0